

VENDIM
Nr.1013, datë 10.12.2010

PËR KRIJIMIN E QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE (QSHA)¹
(Ndryshuar me VKM nr.371, datë 10.12.2017)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ligjit nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e *Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA)*, mbi bazën e AVA-së, APRIAL-it dhe Drejtorisë së Provimit të Shtetit, të krijuar për herë të parë në kuadër të AKP-së.

2. *QSHA*-ja është person juridik, publik dhe buxhetor, në varësi të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

3. *QSHA*-ja është institucion i posaçëm për organizimin, monitorimin, mbikëqyrjen e problemeve të reformës arsimore për sigurimin e cilësisë në fushën e vlerësimit të arritjeve dhe të provimeve. Ajo ushtron funksion teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave të vlerësimit dhe të organizimit të provimeve të maturës e të shtetit.

4. Shfuqizuar.

5. Shfuqizuar.

6. Shfuqizuar.

7. Shfuqizuar.

8. *QSHA*-ja kryen këto funksione:

a) Zhvillon provimet kombëtare, kryen procesin e vlerësimit të arritjes së nxënësve dhe administron bazën e të dhënave të këtyre rezultateve.

b) Kryen dhe administron vlerësime të jashtme kombëtare dhe ndërkombëtare dhe/ose me kampionim për arritjet e nxënësve të sistemit arsimor parauniversitar.

c) Ofron kontribut në hartimin e politikave arsimore e të strategjive dhe në zbatimin e tyre.

ç) Përpunon dhe analizon rezultatet e provimeve kombëtare, të vlerësimeve, të provimeve të shtetit, sipas standardeve bashkëkohore, dhe raportet vjetore të cilat i publikon.

d) Organizon dhe administron Provimin e Shtetit, që zhvillohet përmes teknologjisë digjitale, duke bashkëpunuar me autoritetet kompetente përkatëse, sipas ligjit për profesionet e rregulluara.

dh) Krijon bazën shtetërore të të dhënave për kandidatët e regjistruar në Provimin e Shtetit.

e) Digjitalizon fondet e pyetjeve të miratuara nga komisionet e Provimit të Shtetit dhe e zhvillon këtë provim, përmes teknologjisë digjitale.

ë) Trajnon periodikisht personelin organizues dhe mbikëqyrës të Provimit të Shtetit dhe të provimeve kombëtare.

f) Publikon on-line programin orientues të këtij provimi dhe fondet e pyetjeve për çdo profesion të rregulluar.

g) Administron bazën e të dhënave për arsimin parauniversitar.

gj) Krijon, arkivon, përditëson dhe administron bazën elektronike të të dhënave për arritjet e nxënësve në provimet kombëtare.

h) Kontribuon në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, të cilat janë pjesë e objektit të veprimtarisë së saj.

9. Shfuqizuar.

¹ VKM nr.1013, datë 10.12.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.176/2010, 30 dhjetor.
VKM nr.371, datë 26.4.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.100/2017, 9 maj.

10. *Shfuqizuar.*

11. *Shfuqizuar.*

12. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2010, do të përballohen nga buxheti i këtij viti, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

13. Për punonjësit, të cilët pas riorganizimit humbasin vendet e punës, të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

14. Vendimet nr.135, datë 14.3.2007 e Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Qendrore të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve dhe për shkrirjen e Qendrës Kombëtare Arsimore të Vlerësimit dhe Arritjeve”, të ndryshuar, dhe nr.503, datë 16.4.2008 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë”, shfuqizohen.

15. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha